

DREJTORIA E RAJONIT JUGOR GJIROKASTER
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 21.11.2018

Për: „**Eral Konstruksion**”shpk & ”**Alb Shpresa**” shpk me adrese Njesia Bashkiake nr.7, Rruga e Kavajes, Pall. Nr. 23, Kulla B, Kati 9, Apt. 36, Tirane.
Procedura e prokurimit: Procedure e hapur, sherbime.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF – 74000 -06- 07-2018.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Mirembajtje rutine me performance rruga Tepelene – Dorrez – Qafe Dushk + rruga Sevaster - Kalivac 66,4 km**“ per nje periudhe 2-vjecare.

Fondi limit : 23 371 822 leke pa tvsh.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike dt. 11.06.2018 nr. 23.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomike ”Eral Konstruksion”shpk & ”Alb Shpresa” shpk
NIPT K82230002K; NIPT :J72110003F
Vlera: 15 699 520 (pesembedhjete milion e gjashteqind e nentedhjete e nente mije e peseqind e njezet) leke pa tvsh
- 2.”Shkelqimi 07” shpk NIPT : K68121808W
Vlera : 16 000 000 (gjashtembedhjete milion)leke pa tvsh
- 3.”Sark”shpk NIPT:K52531415H,
Vlera 16 796 460 (gjashtembedhjete milion e shtateqind e nentedhjete e gjashte mije e katerqind e gjashtedhjete)leke pa tvsh
- 4.”Shendelli ” sh.p.k. NIPT : K07924803N
Vlera 16857320 (gjashtembedhjete milion e teteqind e pesedhjete e shtate mije e treqind e njezet) leke pa tvsh.
- 5.”Bashkimi i operatoreve ekonomike ” Balili Konstruksion ” shpk & ”Kupa” shpk
NIPT : K31909007F NIPT K51615512C,
Vlera 17795116 (shtatembedhjete milion e shateqind e nentedhjete e pese mije e njeqind e gjashtembedhjete) lek pa tvsh
6. ”Be – is” shpk NIPT: K71412003A
Vlera : 19356120 (nentembedhjete milion e treqind e pesedhjete e gjashte mije e njeqind e njezet) leke pa tvsh
- 7.”B-93 II” NIPT :L 522090500
Vlera 20611120 (njezet milion e gjashteqind e njembedhjete mije e njeqind e njezet) leke pa tvsh
8. ”Beqiri” shpk NIPT :J98624801V
Vlera : 21003240 (njezet e nje milion e tre mije e dyqind e dyzet) leke pa tvsh
15. Adem Pojani K51524013W (pa oferte)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. "Eral Konstruksion "shpk &"Alb Shpresa"sh.p.k
2. "Sark"shpk
3. "Be – is" shpk
4. "Beqiri" shpk

Perkatesisht per aryet e meposhtme:

1. Bashkimi i Operatoreve ekonomik "Eral Konstruksion" shpk & "Alb Shpresa" sh.p.k rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:

Ne lidhje me deshmitet per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, per kapacitetin teknik "Autobitumatriçe", në pronësi ose me qira, cope 1, ka paraqitur kontraten e qerases me subjektin GE & CO shpk, nenshkruar me date 05.07.2018, me afat qera 3 vite. Po ky mjet me targe TR4893L, i eshte dhene me qera dhe dy subjekteve te tjera 2 T shpk dhe Sterkaj shpk, per te njejten periudhe kohore, ose qe perfshin kete periudhe, cfare e ben fiktive dhe te pavlefshme kete kontrate.

Ne lidhje me deshmitet per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, per kapacitetet teknike "grejder", në pronësi ose me qira, cope 1 dhe "asfaltoshtruese" në pronësi ose me qira, cope 1 operatori ekonomik Eral Konstruksion shpk ka paraqitur kontraten e qerases date 05.07.2018, nenshkruar me subjektin "Feba shpk". Po keto mjete me anen e kontrates se qerases date 27.04.2018, i jane dhene subjektit Caushi shpk, per te njejten periudhe ose qe perfshin kete, cfare verteton faktin qe kontratat jane fiktive dhe te pavlefshme.

Per kapacitetin teknik "Fabrike asfaltobetoni (QKL & Leje mjedisore) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi", operatori ekonomik Caushi shpk ka paraqitur kontrate furnizimi date 06.06.2018, nenshkruar me subjektin "Feba shpk". Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti "Eral Konstruksion shpk", rezulton qe subjekti "Feba shpk", date 06.07.2018, i ka nenshkruar ketij te fundit nje kontrate qeraje, me afat 3 vjecar cfare verteton faktin qe kontratat jane fiktive dhe te pavlefshme.

2.Operatori ekonomik "Sark"shpk rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:

Ne lidhje me mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik sic parashikohet ne piken 2.3.7, te kriterëve te dhena ne dokumentet e tenderit, rezulton qe ky operator nuk ka paraqitur deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion si:

Asfaltoshtruese, në pronësi ose me qira, Copë 1; *mjeti i paraqitur rezulton ne emer te subjektit "Cobial shpk", dhe nuk ka kontrate qeraje. Dhe nese i referohemi deklarates se mjeteve te paraqitur nga vete subjekti, rezulton qe ky mjet eshte me qera deri me 21.06.2019, qe nuk perfshin gjithe periudhen e realizimit te kontrates.*

Autobitumatriçe, në pronësi ose me qira, copë 1: *është paraqitur nje bot bitumi ne kundershtim me kriterin e dhene autobitumatrice.*

Fabrike asfaltobetoni (QKL & Leje mjedisore), në pronësi / me qira ose kontrate furnizim, copë 1; *kontrata me subjektin "Biinvestment shpk" nuk është noteriale ndersa kontrata e furnizimit me subjektin "Cobial shpk", perfundon me 21.06.2019, qe nuk perfshin gjithe periudhen e realizimit te kontrates.*

3.Operatori ekonomik BE - IS shpk, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:

Operatori ekonomik "BE - IS shpk", ka nderhyre ne preventivin e dhene si pjese e dokumenteve te tenderit, duke shtuar dhe mirembjatje dimerore, kjo ne kundershtim me to.

Kontrata e paraqitur per furnzim me asfaltobeton e nenshkruar me subjektin "Bami shpk" rezulton me afat perfundimi perpara mbarimit te kontrates se mirembjatjes, keto ne kundershtim me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit.

Kontrata e paraqitur per furnzim me asfaltobeton e nenshkruar me subjektin "Asab shpk", është me afat perfundimi perpara mbarimit te kontrates se mirembjatjes, ne kundershtim me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit.

Ne lidhje me deshmite per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, per kapacitetin teknik "Autobitumatriçe", në pronësi ose me qira, cope 1, nga dokumentacioni i paraqitur rezulton te jete kamion dhe jo ATV (APV).

4. Operatori ekonomik Beqiri shpk, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:

Ne lidhje me deshmite per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, per kapacitetin teknik "Autobitumatriçe", në pronësi ose me qira, cope 1, ka paraqitur mjetin me targe AA792NI, ne lejen e qarkullimit te te cilit kodi i karrocercise është B2 (jo autobitumatrice). Ne foton e paraqitur nuk duket targa, cfare e ben te pamundur identifikimin e saj.

Per kapacitetin teknik "Fabrike asfaltobetoni (QKL & Leje mjedisore) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi", operatori ekonomik Beqiri shpk ka marre me qera impjantin nga subjekti "Spartaku shpk", date 04.07.2018. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti "Don Jurge shpk" pjesemrres ne kete procedure, rezulton qe subjekti "Spartaku shpk", date 06.07.2018, i ka nenshkruar ketij te fundit nje kontrate furnizimi, me afat 2 vjecar cfare verteton faktin qe kontratat jane fiktive dhe te pavlefshme.

Ka pasur ankesa nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomike "Eral Konstruksion" shpk & "Alb Shpresa"shpk. Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr.725/2018 ka vendosur te pranoje ankesen e Bashkimit te Operatoreve Ekonomike "Eral Konstruksion"shpk & "Alb Shpresa"shpk, duke e kualifikuar kete Bashkim te Operatoreve Ekonomike. Nga ana e Autoritetit Kontraktor u be rivleresimi i ofertave ne daten 06.11.2018 duke kualifikuar dhe klasifikuar fitues Bashkimin e Operatoreve Ekonomike "Eral Konstruksion"shpk & "Alb Shpresa"shpk.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatoreve Ekonomike "Eral Konstruksion" shpk & "Alb Shpresa" me adrese Njesia Bashkiake nr.7, Rruga e Kavajes, Pall. Nr. 23, Kulla B, Kati 9, Apt. 36, Tirane, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 15 699 520 (pesëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e nentëdhjetë e nente mijë e pesëqind e njetzet) leke pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorise se Rajonit Jugor Gjirokaster, nr. tel. 084262529 me adrese, ish Zona Industriale Gjirokaster, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.11.2018

Ankesa: Ka pasur ankesa nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomike "Eral Konstruksion"shpk," & "Alb Shpresa"shpk," ne daten 09,08.2018 prane AK. Ka marrë përgjigje në datë: 14.08.2018, me shkresen nr.551 nga AK . Ne daten 23.08.2018 ky subjekt ka paraqitur ankesë prane KPP .Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr.725/2018 ka vendosur te pranoje ankesen e Bashkimit te Operatoreve Ekonomike "Eral Konstruksion"shpk & "Alb Shpresa"shpk, duke e kualifikuar kete Bashkim te Operatoreve Ekonomike. Nga ana e Autoritetit Kontraktor u be rivleresimi i ofertave ne daten 06.11.2018 duke kualifikuar dhe klasifikuar fitues Bashkimin e Operatoreve Ekonomike "Eral Konstruksion"shpk & "Alb Shpresa"shpk.